

KËRKESË

PËR MARRJEN ME QIRA TË AMBJENTEVE NGA TË TRETËT PËR NEVOJA TË SISTEMIMIT TË ZYRËS PËRMBARIMORE LUSHNJË

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit njofton se kërkon të marrë më qira ambjente për ushtrimin e veprimtarisë së Zyrës Përmbarimore Lushnjë, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

I. Kriteret specifike të ambjenteve objekt qiramarrje:

- Ambjent për zyra me sipërfaqe totale jo më pak se 50 m² dhe jo më shumë se 80 m² ku duhet të përfshijë ambjent të mjaftueshëm për mbarrëvajtjen e punës, zyra (zyra për punonjësit, arkivë, zyrë pritje dhe hapësirë për realizimin e takimeve me fëmijë) dhe 1 tualet të (kompletuar me pajisjet hidrosanitare dhe pajisjet për ujë).
- Ambjentet duhet të kenë të instaluar sistem vëzhgimi me kamera në hyrje të tyre.
- Ambjentet duhet të kenë furnizim me ujë dhe energji elektrike 24/7 dhe të jenë të pajisura me matës të dedikuar të ujit të dhe energjisë elektrike.
- Ambjentet duhet të kenë sistem kondicionimi, të instaluar dhe plotësisht funksional.
- Ambjentet duhet të kenë rrjet interneti të instaluar, si dhe rrjetin e prizave të energjisë elektrike, për çdo post pune.
- Ambjentet duhet të jenë të përfunduara me dyer, dritare, të lyera dhe të gatshme për tu shfrytëzuara nga qiramarrësi. Dera kryesore hyrëse në këto ambjente duhet të jete me konstrukcion të sigurtë.
- Statusi juridik i pronës që do të merret me qera duhet të jetë në pronësi të pronarit. (*Objekti të jetë i hipotekuar dhe të ketë gentplan*).
- Vendndodhja e ambjenteve duhet të jetë në qytetin e Lushnjës dhe sa më pranë qendrës së qytetit, për të siguruar një bashkëveprim dhe komunikim efektiv ndërmjet zyrës vendore dhe qytetarëve të interesuar për shërbimet e ofruar nga kjo zyrë.
- Ambjenti duhet të ketë mundësi ajrimi si dhe kushte higjieno - sanitare të mira, duke ofruar në tërësinë e tij imazhin e një zyre shërbimi funksionale dhe në shërbim të qytetarëve.
- Ambjentet duhet të jenë të lira, në mënyrë që dorëzimi të bëhet brenda 5 (pesë) ditëve pune nga njoftimi për lidhje kontrate.
- Pagesa e qirasë do të bëhet çdo muaj në llogarinë në lekë të qiradhënësit, brenda ditës që palët do të bien dakort në kontratën më shkrim, kundrejt faturës tatimore elektronike për subjektet tregtare.
- Në rast se qiradhënësi është individ dhe nuk mund të lëshojë faturë tatimore, pagesa e detyrimeve do të kryhet nga Drejtoria e përgjithshme e Përmbarimit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për taksat dhe tatimet dhe shuma e detyrimeve do të zbritet qiradhënësit nga vlera e qirasë.
- Afati kontratës së qirasë do të jetë nga momenti i lidhjes së kontrates deri em date 31.12.2024 deri, me të drejtë rinovimi. Afati do të përcaktohet gjithmonë nga qiramarrësi, i cili njofton me shkrim 30 ditë para mbarimit të kontratës qiradhënësin.
- Detyrimet që lindin nga përdorimi i energjisë elektrike, ujit dhe internetit gjatë periudhës së vlefshmërisë së Kontratës së qirasë do të përmbushen nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit;
- Çmimi i ofruar nga Ofertuesi/Qiradhënësi duhet të përcaktoje (*oferta ekonomike*) vlerën mujore të qirasë për një muaj, duke përfshirë të gjitha detyrimet tatimore sipas legjislacionit të fuqi;
- Qiradhënësi qoftë individ apo tregtar duhet të garantojë se objekti i marrë me qera nuk ka asnjë detyrim ndaj OSHEE-së apo UKT.
- Qiradhënësi duhet të dorëzojë ofertën brenda 7 ditëve nga dita e publikimit të njoftimit për shprehje interesi.
- Oferta duhet të perzgjidhet, pas plotësimit të kriterëve ligjore dhe kërkesave kualifikuese të përcaktuara në njoftimin për marrjen e ambjenteve me qera, bazuar në çmimin më të ulët të ofruar nga të interesuarit/ofertuesit.

II- Kriteret ligjore që duhet të plotësojnë ofertuesit qoftë individë, agjenci imobilare apo shoqëri tregtare që disponojnë ambjente për ti ofruar me qira, janë:

- Të jenë titullarë të ligjshëm të pronës të vërtetuar me certifikatë pronësie, lëshuar nga ASHK-ja, shoqëruar me kartelën e pasurisë, hartën treguese të pronës dhe Gent –planin.
- Vërtetim hipotekor që prona nuk është në sekuestro dhe është e lirë nga çdo barrë hipotekore apo detyrim ligjor, lëshuar nga ASHK-ja.
- Vërtetim nga FSHU-ja që nuk ka detyrime ligjore të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit të energjisë elektrike.
- Vërtetim nga UKT-ja që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit nga Ujësjetllës Kanalizime.
- Vërtetim që ofertuesi nuk është në ndjekje penale apo proces gjyqësor.
- Nëse është tregtar/shoqëri tregtare duhet të paraqesë edhe:
 - a- NIPT/NUIS, certifikata e regjistrimit dhe ekstrakt historik i regjistrimit të subjektit që vërteton se ka status aktiv.
 - b- Vërtetim nga tatim taksat që nuk ka detyrime të pashlyera.
 - c- Vërtetim që nuk ka sigurime shoqërore të pashlyera nga e-Sigurime.
 - d- Vërtetim nga institucionet përkatëse që subjekti apo përfaqësuesi ligjor i tij nuk është në ndjekje penale si dhe nuk është në process gjyqësor në lidhje me aktivitetin.
- Vetëdeklarim që ofertuesi nuk është në konflikt interesi me Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit dhe Zyrën Përmbartimore, Lushnjë.
- Vetëdeklarim për plotësimin e të gjitha kriterëve ligjore dhe kërkesave specifike të ambjenteve që kërkohen.
- Ofertën më shkrim të çmimit të qirasë së ambjenteve në muaj, të nënshkruar nga ofertuesi.
- Oferta fituese do të jetë oferta me çmimin më të ulët, e cila plotëson të gjitha kriteret ligjore dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin e marrjen e ambjenteve me qira për zyra, për Zyrën Përmbartimore, Lushnjë.
- Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

III- Dorëzimi i dokumentave dhe ofertës ekonomike duhet të bëhet brenda datës 30.05.2024 ora 16.00 pranë Zyrës Përmbartimore Lushnjë, e cila rezervon të drejtën e verifikimit të vend të ambjenteve dhe paraqitjes së një vlerësimi për ambjentet.

- Për çdo komunikim apo sqarim, ofertuesit mund të shkruajnë në adresën elektronike info@dpp.gov.al.